




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No	01-3367/13
Data Datum Date	14.10.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2705/13, për z. Ramë Melaj – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Deçanit, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2705/13, për zyrtarin e lartë z. Ramë Melaj – Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Deçanit, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin individual N.P.N. “ALB PROJEKT”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Melaj me datë 24.09.2013 është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik dhe se ka të drejtë që në afatin prej 15 ditësh të njoftohet për faktet që posedon Agjencia.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim ai ka pranuar se e ushtron pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit në

Komunën e Deçanit, dhe se është pronar dhe person i autorizuar në biznesin privat N.P.N. "ALB PROJEKT".

Gjatë takimit, pasi është bindur për situatën e mundshme të konfliktit të interesit, ai ka premtuar se në afatin ligjor do të heqë dorë nga personi i autorizuar i këtij biznesi dhe në vend të tij do ta autorizoj një person të besueshëm që ta udhëheq kompaninë.

Pas kësaj, z. Melaj, ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve (DPKI 03-3226/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka hequr dorë nga të qenurit person i autorizuar në biznesin e lartpërmendur dhe ka autorizuar një person të besueshëm për udhëheqjen e këtij biznesi.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur pasi që z. Ramë Melaj ka bërë ndryshimet e nevojshme.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

